

Anëtarësim I Pjesshëm

ERIAC është një organizatë e bazuar në anëtarësim, që sjell së bashku individë dhe organizata Rome dhe jo-Rome, me kompetenca të demonstruara e relevante dhe eksperiencë në fushën e artit e të kulturës të cilët janë të përkushtuar ndaj vlerave të ERIAC-ut.

Anëtarët e pjesshëm të ERIAC janë organizuar në katër seksione tematike:

- Arte dhe Kulturë
- Histori dhe Përkujtim
- Kërkime dhe Publikime në fushat e artit dhe kulturës
- Media dhe Informacioni në fushat e artit dhe kulturës

Cilat janë përfitimet i të qënurit anëtar i pjesshëm i ERIAC?

Anëtarët e pjesshëm kanë rol kyç në ndërtimin e burimeve të ERIAC, duke u angazhuar në shkëmbime krijuese dhe bashkë-prodhim, duke marrë në pronësi iniciativat dhe angazhim në vendimmarrje të ERIAC.

Si një anëtar i pjesshëm:

- Do të kesh akses të plotë në informacionin dhe njohuritë në burimet, koleksionet, arkivat dhe bazat e të dhënave të ERIAC.
- Do të jesh i përfshirë sa më shumë të jetë e mundur në programin e aktiviteteve të ERIAC.
- Do të jesh i ftuar për të sygjerruar iniciativa kulturore, artistike dhe partneritete.
- Nëpërmjet seksioneve tematike, do të keni mundësi për ti dhënë formë prioriteteve dhe aktiviteteve të ERIAC.
- Do të jesh pjesë e platformës për shkëmbim idesh dhe ekspertize të ERIAC.
- Bazuar në kushtet e vendosura nga ERIAC, do të kesh mundësi për të vendosur logon dhe emrin e institutit në aktivitetet e tua.
- Do të kesh të drejtën për të marrë pjesë në Asembletë e Përgjithshme.
- Do të mund të nominoni anëtarë të [Barvalipe Academy](#) ose të kandidoni për anëtar të Barvalipe Academy.

Kush mund të bëhet pjesë?

ERIAC është e hapur për të gjithë artistët Romë dhe jo-Romë, menaxherë kulturorë, individë të interesuar, organizata të shoqërisë civile, kompani private, grupe formale dhe jo formale me kompetenca të demonstruara dhe eksperiencë në fushën e arteve dhe kulturës që mbështet qëllimin e ERIAC dhe që janë të gatshëm për të kontribuar në implementimin e fuqizimit të vizionit të ERIAC.

Aplikimet pranohen nga persona juridikë dhe fizikë.

Cilat janë kërkesat për të qënë një anëtar I pjesshëm?

- Aplikimet e anëtarëve shikohen nga Menaxheri Ekzekutiv dhe Bordi I Pakiv, bazuar në demonstrimin e meritave dhe kualifikimeve në fushën e gjerësisht-kuptuar arte dhe kulturë.
- Anëtarët e pjesshëm duhet të zotohen për të respektuar principet e fondit të ERIAC.
- Anëtarët e pjesshëm priten të paguajnë tarifën e zakonshme të anëtarësimit.
- Anëtarët e pjesshëm bazuar në preferencat dhe eksperiencat e veta, u kërkohet të zgjedhin në seksionin e tematikave. Anëtarët e pjesshëm mund të zgjedhin më shumë se një seksion.

Si mund të bëhem një anëtar i pjesshëm?

Thirrja për anëtarë të pjesshëm do të hapet me rastin e festimit te Ditës Ndërkombëtare Rome – 8 Prill – dhe do të vazhdojë të jetë e hapur deri në fund të Qershorit. Anëtarësimi I pjesshëm ofrohet duke plotësuar një formë aplikimi online.

Të gjitha aplikimet do të vlerësohen nga Menaxheri Ekzekutiv I ERIAC dhe Bordi I Pakiv. Pasi aprovohet aplikimi, aplikuesi do të duhet të vërtetojë pagesën e bërë për të qënë anëtar I plotë.